

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
TRAGJAKUMI SHPK

Neni 1

Emri

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është TRAGJAKUMI SHPK, që këtu e më poshtë do të quhet "Shoqëria".

Neni 2

Themelimi

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe këtë Akt Themelimi.

Neni 3

Selia

3.1 Adresa e zyrës qendrore të Shoqërisë është në: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Perlat Rexhepi, Pallati Nr. 6, Ap. 3, Nr. Pasurisë 4/73+1-4, Zona Kadastrale 8260, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç zyrës qendrore të Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

Neni 4

Ortaku i Vetem i Shoqërisë

4.1 Ortaku i Vetem i Shoqërisë është:

NAIL JAKUPI, i biri i Brahimit, lindur me 17.06.1965, banues në Vlorë, në Rruga Ali Demi, Lagjia Partizani, Banese Private, Nr. 65, mbajtes i leternjoftimit nr. G50617105B, i cili zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributin e nënshkruar në shumën prej 9,520,820 (nëntemilione e pesëqind e njëzet e teteqind e njëzet) Lekë, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë, kapital në natyrë.

Neni 5

Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 9,520,820 (nëntemilione e pesëqind e njëzet e teteqind e njëzet) Lekë dhe është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku i Shoqërisë.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga 1 (nje) Ortak i Vetem, si më poshtë:

NAIL JAKUPI, i biri i Brahimit, lindur me 17.06.1965, banues ne Vlore, ne Rruga Ali Demi, Lagjia Partizani, Banese Private, Nr. 65, mbajtes i leternjoftimit nr. G50617105B, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributin e nënshkruar në shumën prej 9,520,820 Lekë, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë.

5.3 Përgjegjësia e ortakut për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

5.4 Kuota, me vendim të Ortakut të Vetem te Shoqërisë është lirisht e transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji.

Neni 6

Objekti

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

Ofrimi i shërbimeve në fushën e komunikimeve elektronike, në veçanti ofrim i shërbimit si operator i rrjetit dhe i shërbimeve të internetit, transmetimit të të dhënave, ofrimin e shërbimeve si operator i rrjetit dhe i shërbimeve të telefonisë publike të qendrueshme, telefonisë së llojeve të tjera, shërbime të VoIP, shërbime telefonie me kartë të parapaguar, operator i shërbimeve të të dhënave, operator i rrjeteve kabllore televizive, ofues i shërbimit të televizionit kabllor rrjeteve të konsulencës, i shërbimeve programore audio dhe audiovizuale.

6.2 Gjithashtu Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Kohëzgjatja

7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 8

Kompetencat e Ortakut të Vetem

13.1 Ortaku i Vetem vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;

- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j) shpërndarjen e fitimeve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l) çështje të tjera të caktuara nga ligji ose nga ky Statut.

Neni 9

Administratori/ët

9.1 Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person/a fizik/ë, i/të cilët emërohen nga Ortaku i Vetem sipas këtij Statuti.

9.2 Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

9.3 Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Ortakut te Vetem sipas ligjit.

9.4 Administrator i Shoqërisë është:

NAIL JAKUPI, i biri i Brahimit, lindur me 17.06.1965, banues ne Vlore, ne Rruga Ali Demi; Lagjia Partizani, Banese Private, Nr. 65, mbajtes i leternjoftimit nr. G50617105B.

Neni 10

Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes organeve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar, sot më datë **01.02.2018**.

Ortaku i Vetëm

Z. NAIL JAKUPI

